

Vendim nr. 112 datë 20.05.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare
Marsida Xhaferllari, Anëtare
Marjana Semini, Anëtare

në datën 20.05.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 4 (T) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: TAULANT XHINI, përfaqësuar nga avokat Saimir Vishaj, me akt përfaqësimi.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 00-2022-738, datë 24.06.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; nr. 44, datë 27.04.2016 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda; nr. 11, datë 27.01.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 50, pika 4, 51/a, pika 1, shkronja “b”, 71, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N :

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë në datën 04.04.2014 ka regjistruar procedimin penal nr. 197/2014 ndaj shtetasit Taulant Xhini (*kërkuesi*) për kryerjen e veprave penale “Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit”, në dëm të katër shtetasve, në bashkëpunim, të mbetur në tentativë, dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe i municionit”, të parashikuara nga nenet 79/b, 22, 25 dhe 278, paragrafi 4, të Kodit Penal (KP). Në datën 12.04.2014 prokurori ka shpallur moskompetencën lëndore dhe ka urdhëruar kalimin e akteve Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me arsyetimin se, bazuar në nenet 75/a, 83, pika 1 dhe 84 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), hetimi i procedimit penal nr. 197/2014 nuk përfshihej në kompetencën e saj lëndore.

2. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka pranuar aktet dhe ka regjistruar procedimin penal nr. 131/2014, datë 28.04.2014. Më tej, ajo gjykatë, me vendimin nr. 189, datë 28.04.2015, ka vendosur caktimin e masës së sigurimit “Arresti në burg” ndaj kërkuesit, e cila është ekzekutuar në datën 06.05.2015.

3. Gjatë hetimeve paraprake, në datën 22.06.2015, prokurori i ka njoftuar kërkuesit në prani të mbrojtësit të zgjedhur prej tij akuzat e parashikuara nga nenet 79/b, 22, 25 (katër herë) dhe 278, paragrafi 4, të KP-së. Në të njëjtën datë, prokurori, bazuar në nenin 93, pika 1, shkronja “ç”, të KPP-së, ka vendosur ndarjen e procedimit penal në dy: procedimin penal nr. 131, në ngarkim të kërkuesit dhe procedimin penal nr. 131/1 të vitit 2014 për hetime të mëtejshme, me arsyetimin se hetimet në ngarkim të kërkuesit kishin përfunduar, ndërsa vazhdonin veprimet për identifikimin e bashkëpunëtorit/bashkëpunëtorëve të tjerë. Gjithashtu, prokurori ka arsyetuar se ndarja e procedimeve nuk dëmtonte vërtetimin e fakteve. Në vijim, në datën 06.07.2015, prokuroria ka paraqitur në gjykatë kërkesën për gjykimin e çështjes penale ndaj kërkuesit, sipas akuzave.

4. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr. 11, datë 27.01.2016, ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuesit për veprat penale “Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit”, kryer në dëm të katër shtetasve, në bashkëpunim, të mbetur në tentativë, të parashikuara nga nenet 79/b, 22 e 25, në lidhje me nenin 23, pika 2, të KP-së dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe i municionit”, të parashikuar nga neni 278, paragrafi 4, i KP-së, duke e dënuar përfundimisht atë me 35 vjet burgim.

5. Mbi bazën e ankimit të kërkuesit, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr. 44, datë 27.04.2016, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë vetëm për akuzën e mbajtjes pa leje të armëve luftarake, duke e cilësuar atë sipas nenit

278, paragrafi 5, të KP-së. Ajo ka arsyetuar se neni 278 i KP-së ka ndryshuar si në formulim, ashtu edhe në renditje paragrafësh me anë të ligjit nr. 135/2015, datë 05.12.2015 dhe vendimit nr. 9, datë 26.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), ndaj për kërkuesin duhej zbatuar dispozita penale më favorizuese, bazuar në nenin 3, paragrafi 3, të KP-së. Disponimet e tjera të vendimit, përfshirë masën përfundimtare të dënimit penal, janë lënë në fuqi. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka ushtruar rekurs.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-738, datë 24.06.2022, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk përmbante shkaqet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së.

7. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës duke kundërshtuar vendimet e të tria gjykatave edhe një herë tjetër me pretendime që lidhen me: (i) cenimin e *së drejtës së aksesit*; (ii) *standardit të arsyetimit të vendimit*; (iii) *parimit të prezumimit të pafajësisë*. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 66, datë 04.04.2023 (*vendimi nr. 66/2023*), ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, pasi pretendimet kanë rezultuar haptazi të pabazuara.

8. Në datën 08.04.2024 (sipas shërbimit postar), kërkuesi i është drejtuar për herë të dytë Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Meqenëse kjo kërkesë e dytë ka rezultuar e paplotë është kërkuar plotësimi i saj dhe pasi është plotësuar me aktet përkatëse, sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 25.04.2024.

II

Pretendimet e kërkuesit

9. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara i kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

9.1. *Së drejtës së aksesit*, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka dëgjuar pretendimet e kërkuesit, duke i mohuar atij të drejtën për të pasur nga gjykata një zgjidhje përfundimtare për çështjen objekt gjykimi.

9.2. *Parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme*, pasi gjyqtarët e të tria shkallëve nuk janë treguar të paanshëm në shqyrtimin e çështjes.

9.3. *Së drejtës për t'u njoftuar*, pasi edhe pse vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është marrë në datën 24.06.2024, kërkuesit të dënuar i është komunikuar ky vendim në datën 15.03.2024, pothuajse 2 vjet, pasi gjykimi i çështjes ka përfunduar në Gjykatën e Lartë.

- 9.4. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë abuzon kur shprehet se Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka dhënë përgjigje për secilin pretendim, pasi në fakt ajo gjykatë ka arsytuar njëloj si Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, duke mos u shprehur për shkaqet e paraqitura në ankim, për sa i takon cilësimin juridik të veprës penale për të cilën është deklaruar fajtor.
- 9.5. *Së drejtës për ankim efektiv*, pasi në rastin konkret ankimi në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda dhe rekursi në Gjykatën e Lartë nuk kanë rezultuar të jenë mjete ankimi efektive.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkesit

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Rregullimet e veçanta në lidhje me shqyrtimin e kërkesave përcaktohen nga neni 31/a, pika 2, i ligjit nr. 8577/2000, në shtesë të kriterëve të mësipërme. Ato kanë të bëjnë me juridiksionin e Gjykatës, legjitimitimin formal të kërkesit dhe të përfaqësuesit, si dhe me respektimin dhe vlerën e vendimmarrjeve të mëparshme të Gjykatës. Ky kriter i fundit përcaktohet nga shkronja “dh” e pikës 2 të nenit 31/a, sipas së cilës, nëse kërkimet e paraqitura në kërkesë janë objekt i një vendimi të mëparshëm, vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

12. Duke mbajtur në konsideratë që i njëjti kërkes i është drejtuar për herë të dytë Gjykatës për kundërshtimin e të njëjtave vendime (*për të cilat është shprehur një herë Kolegji me vendimin nr.66/2023*), Kolegji vlerëson të verifikojë, paraprakisht, nëse pretendimet e ngritura i janë nënshtruar me parë kontrollit kushtetues dhe përbëjnë “*gjë të gjykuar*”.

13. Gjykata ka theksuar se në aspektin formal e procedural, “gjë e gjykuar” nënkupton përfundimin në drejtim të mosankueshmërisë së vendimit, ndërsa në aspektin substancial

nënkupton fuqinë e detyrueshme të vendimit. Ky parim është i zbatueshëm jo vetëm ndaj palëve në gjykim, por edhe ndaj të gjitha autoriteteve publike brenda juridiksionit që janë të interesuara ose të përfshira në përmbajtjen e vendimit të Gjykatës. Kufijtë e zbatimit të parimit të gjësë së gjykuar përcaktohen në lidhje të ngushtë me thelbin e mosmarrëveshjes në gjykim. Në këtë aspekt, gjëja e gjykuar përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit, por edhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkuese arsyetuese të tij, për sa u përket fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit për të cilin Gjykata ka dhënë vendimin (*shih vendimet nr. 7 datë 23.02.2021; nr. 4 datë 15.02.2021; nr. 78 datë 12.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Gjykata në praktikën e saj ka pranuar rishqyrtimin e kërkesës së të njëjtit individ, me të njëjtin objekt, kur përmes një kërkesë tjetër, brenda afatit ligjor të parashikuar nga ligji nr. 8577/2000, ka argumentuar një shkak të ri për antikushtetutshmërinë e vendimmarrjes së gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimin nr. 21, datë 29.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, një prej kriterëve që përcakton kufijtë e juridiksionit të Gjykatës parashikohet nga shkronja “dh” e pikës 2 të nenit 31/a të ligjit nr. 8577/2000, sipas së cilës kur kërkimet e paraqitura në kërkesë janë objekt i një vendimi të mëparshëm të Gjykatës, vendoset moskalimi i çështjes në seancë plenare. Ky rregull ligjor synon të garantojë sigurinë juridike, duke parandaluar kërkesat për rishqyrtimin e vendimmarrjes së mëparshme të Gjykatës nga të njëjtët kërkues, për të njëjtat fakte dhe për të njëjtat pretendime.

15. Kolegji konstaton se në rastin e parë që kërkuesi ka vënë në lëvizje gjykimin kushtues me vendimin e Kolegjit nr. 66/2023, është vendosur moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare, sepse Kolegji në atë rast ka vlerësuar se pretendimet e kërkuesit ishin haptazi të pabazuara. Në gjykimin e parë kërkesa është paraqitur personalisht nga kërkuesi dhe ai ka pretenduar: (i) *cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë*; (ii) *të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*; (iii) *parimit të prezumimit të pafajësisë*. Dy prej këtyre pretendimeve dhe më konkretisht ato që lidhen me: (i) *cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë*; (ii) *të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* kërkuesi i ka ngritur sërish edhe në kërkesën e dytë objekt shqyrtimi. Nisur nga sa më sipër, në rastin konkret, meqenëse një pjesë e pretendimeve janë të njëjta me ato të kërkesës dhe gjykimit të parë, Kolegji vlerëson të marrë në shqyrtim vetëm pretendimet e reja të kërkuesit, pra ato që lidhen me: (i) *cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme*; (ii) *së drejtës për t’u njoftuar*; (iii) *së drejtës për ankim efektiv*. Për sa më sipër, pretendimet e kërkuesit lidhur me cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, Kolegji i ka pasur objekt shqyrtimi në

vendimmarrjen e tij të mëparshme për të njëjtat shkaqe, për rrjedhojë ato përbëjnë “gjë të gjykuar”.

16. Lidhur me këto pretendime, Kolegji vlerëson se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

17. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 12, datë 09.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Kolegji vlerëson se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar mjetet e ankimit në formë dhe substancë, ndërkohë që për vendimin e Gjykatës së Lartë ai nuk ka mjet tjetër ankimi përveç ankimit kushtetues individual.

19. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata kur kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Kërkuesi ka pretenduar se ai është njohur me vendimin e arsyetuar në datën 15.03.2024, kur sipas tij i është komunikuar vendimi me shkresën nr. 1302/1 prot., datë 15.03.2024 të Gjykatës së Lartë. Kolegji konstaton se vendimi nr. 00-2022-738, datë 24.06.2022 i Gjykatës së Lartë është bërë i disponueshëm për kërkuenin në datën 16.09.2022, ndërkohë që dijenia e tij provohet edhe me faktin se ai ka paraqitur kërkesë në Gjykatë edhe më parë, në datën 07.12.2022, për kundërshtimin e të njëjtave vendime që janë objekt i kërkesës në shqyrtim.

20. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se ndonëse kërkesa aktuale (këtë radhë është përgatitur nga përfaqësuesi i kërkuetit) nuk e ka përmendur kërkesën e paraqitur më parë në Gjykatë, përsëri reflekton vazhdimësinë e kërkesës së mëparshme me pretendime pjesërisht të njëjta. Kështu, pretendimet për cenimin e *së drejtës së aksesit në gjykatë* dhe të *standardit të arsyesimit të vendimit gjyqësor* ripërsëriten edhe në kërkesën objekt shqyrtimi, ku janë shtuar

edhe tre pretendimet e tjera, ato lidhur me cenimin e *parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, së drejtës për t'u njoftuar dhe së drejtës për ankim efektiv*. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka respektuar kërkesën e paraqitjes së këtyre tre pretendimeve të reja brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

21. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “ç” dhe “dh”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.